



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 35

Tiranë – E hënë, 16 shtator 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 2988, datë 10.9.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Shpëtim Daku”..... 3
Kërkesë e Agjencisë së Trajtimit të Pronave nr. 9887, datë 10.9.2019	Për publikim shtesë të regjistrit të vendimeve, të cilat kanë njohur të drejtën për kompensim dhe vlerësimeve për vitet 1995–2008..... 4
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 5676, datë 12.9.2019	Për shpalljen e 1 vend vakant për pozicionin “Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve” në këtë institucion..... 6
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1125, datë 13.9.2019	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Bashkisë Tropojë..... 6
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1126, datë 13.9.2019	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë..... 7

**KËRKESË****Nr. 2988, datë 10.9.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “SHPËTIM DAKU”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“SHPËTIM DAKU”

**KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku**

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000590-5

Datë 23.8.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000590-2, datë 25.7.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Shpëtim Daku, me NIPT L21331010C, përfaqësues i autorizuar i subjektit Shpëtim Daku (Administrator), prej datës 25.7.2019, ora 15:00 deri më datën 25.7.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datën 25.7.2019 dhe e njoftoi më datën 25.7.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, neni 29, pika 1/a/ii.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit," të ndryshuar, datë 14.7.2011, neni 29, pika 1/a/ii, Subjekti ushtron aktivitetin e demontimit të makinave në fund të jetës, i papajisur me leje mjedisore përkatëse. Zhvillimi i veprimtarisë që është subjekt i një lejeje mjedisi tipi B pa lejen përkatëse të mjedisit, dënohet me masë administrative gjobë. Ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
 - Gjobë 500 000 Lekë
2. Dënim administrativ plotësues:
 - Pezullim të aktivitetit deri në pajisjen me lejen mjedisore përkatëse.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:
Genci Hicka ID: 0301020016
Ilir Nishani ID: 0301020022

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti Shpëtim Daku ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërrave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

Nr. 9887, datë 10.9.2019

për vitet 1995–2008

[illegible]

Dok. ligjor për përveçshmëri e c. kadastral të origjinës	Një e këtyre (kompensoar fuqishëm) përfundimtar						Një për kompensoim përfundimtar										VLERËSIMI	SHËNIMI		
	Zerri kadastral i origjinës						Zerri kadastral i origjinës						Zerri kadastral aktual							
	Sipërfaqja m2 totale	Zerri kadastral aktual	Zerri kadastral toke bregësore	Zerri kadastral kullor - bre ndih.	Zerri kadastral përk.	Zona kadastrale	Sipërfaqja m2 totale	Zerri kadastral aktual	Zerri kadastral toke bregësore	Zerri kadastral kullor - bre ndih.	Zerri kadastral përk.	Zona kadastrale	Zerri kadastral aktual	Zerri kadastral toke bregësore	Zerri kadastral kullor - bre ndih.	Zerri kadastral përk.				
Ne baze të vertetimit të promesise lodhëse nga Sektori i Kadastrës Shkoder dh 19/08/1994 ;							2000	0	2000	0	0	1920	2000	0	0	0	276,400			
Referuar vertetimit të depozitimit sipas vendimit nr. 116, dt. 30.12.1987, për nga figuron "Kopshë", për këtë arsye nuk mund të përcaktohet zeri kadastral i origjinës së promes. Referuar hartes Qytet të vitetë 1937-1938 zeri kadastral i origjinës toke bregësore ;	524		524			1785,8524	8996,00 dhe Parafsheje 270,00	0	9176	0	0	1785,8524	9176	0	0	0	-5,166,036	Subjekti konsiderohet i kompensoar		
Vertetimi promesise kadastral nr 484, ka putur ne procesi 3 dy e 540 m2 baze; Referuar vertetimit di 03.06.1995 lodhëse nga Sektori i Kadastrës Shkoder vertetohet se ne emer te Sadik Diliçevit nuk kemi dokumente depozitimi. Referuar hartes Qytet 1937-38 për sip. 568 m2, 300 m2 toke turrall për ne konstatim e kësaj sipërfaqe rrethohet objektet dhe pjesa (shtet 208m2 toke bregësore. Për sip 2900 m2 nga hartu Qytet 1937-1938 zeri i origjinës toke bregësore. Vertetimi promesise kadastral nr 484, ka putur ne procesi 3 dy e 540 m2 baze; Referuar vertetimit di 03.06.1995 lodhëse nga Sektori i Kadastrës Shkoder vertetohet se ne emer te Sadik Diliçevit nuk kemi dokumente depozitimi. Referuar hartes Qytet 1937-38 për sip. 568 m2, 300 m2 toke turrall për ne konstatim e kësaj sipërfaqe rrethohet objektet dhe pjesa (shtet 208m2 toke bregësore. Për sip 2900 m2 nga hartu Qytet 1937-1938 zeri i origjinës toke bregësore.	568	300	268			8592,1495	2900	0	2900	0	0	8592,1495	2900	0	0	0	-2,420,404	Subjekti konsiderohet i kompensoar		
Vertetimi kadastral i vitit 1946 shprehjet për 26 dhym toke bregësore dhe 2 dhym llovdh. Nuk mund të bëhet përcaktimi i zeri kadastral me ndajen e procedurës sipas vendimit. Referuar hartes se RJPF 41 Toke bregësore.; Vertetimi kadastral i vitit 1946 shprehjet për 26 dhym toke bregësore dhe 2 dhym llovdh. Nuk mund të bëhet përcaktimi i zeri kadastral me ndajen e procedurës sipas vendimit.	5420		5420			3426,8110	150,00 dhe Parafsheje 225,30,00	0	22680	0	0	3426,8110	22680	0	0	0	-115,881,460	Subjekti konsiderohet i kompensoar		
zeri kadastral edhe toke bregësore sipas vertetimit nga regji kadastral i vitit 1946, libri 5, fq 32, nr 10)							100000	0	100000	0	0	1514	0	100000	0	0	3,302,523			
Referuar Plani Urbanistik Titane v 1943-1948)	135	135				8380	791	791	0	0	0	8380	791	0	0	0	52,972,479			
sip. e zhetur pasi dhe e përfutur me ligjin 7501 , nga trashëgimtarja Feride Mena.;							45000	0	45000	0	0	2280	0	45000	0	0	723,743			
Referuar vendimit nr. 550 date 28.06.1994 i Qytetit se Rrethit Shkupor edhe konstatuar se: nuk mund të përcaktohet zeri kadastral i origjinës së promes.							3264	0	0	0	0	1633	3264	0	0	0	1,576,538			
VERTETIMI KADASTRAL DT. 27.02.2002 - FLET PËR DSA ZERA KADASTRAL DHE NUK IDENTIFIKOHET CILA PËRJE PARCELAVE TRAJTOHET ME VENDIM.							10105	0	0	0	0	1666	0	0	0	0				
Referuar dokumentacionit na deshe vertetimi promesise nr. 75 prej , date 04.02.2003 lodhëse nga SMMT Korre edhe konstatuar se, nga verifikimi i dokumenteve Titre Regjistrimi i Promesive bregësore Qytetor te vitit 1945 qe ndodhen ne aktivin e kadastrës se rrethit Korre rezultoi ne emer te Feride Bithani ne procesi ne depozit. etc.							174000	0	174000	0	0	1538,3088	0	174000	0	0	24,120,000			
Vertetimi promesi nr 214 flet për sipërfaqje pa e përcaktuar llojin. Zeri kadastral aktual sipas hartes se vendimit. Referuar hartes RJPF se vitit 1941, proma rezultoi toke bregësore.							736000	0	736000	0	0	1380	0	736000	0	0	267,804,000			

Drejtor i Përgjithshëm
Jonida BACI

**KËRKESË**

Nr. 5676, datë 12.9.2019

**PËR SHPALLJEN E 1 VENDI VAKANT
PËR POZICIONIN “SPECIALIST PËR
ZBARDHJEN DHE REDAKTIMIN E
VENDIMEVE” NË KËTË INSTITUCION**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: IV-a

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në degën gjuhë-letërsi.
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të kenë të paktën tre vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundravajtje penale.
- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar).
- Dëshmi penaliteti.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-premte ora 8:30-17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM

Nr. 1125, datë 13.9.2019

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE NË
ADMINISTRIM TË BASHKISË TROPOJË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Tropojë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	“Dyqan artikuj të ndryshëm”	Valbonë, Tropojë	1 037 794	1 025 794	12 000	75	75	1.10.2019	12:00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimit brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimit brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë www.financa.gov.al

NJOFTIM

Nr. 1126, datë 13.9.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES INDUSTRIALE NR. 1, TIRANË

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Ndërmarrjes Industriale Nr. 1, Tiranë.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (Mjete kryesore + mjete xhiro)	Mjetet kryesore	Mjetet e xhiros	Trualli		
1	Objekte të mbetura pa privatizuar të "Ndërmarrjes Metalike"	Tiranë	63 654 212	63 654 212	0	238 684 865	7 645.5	3 540.7



Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrues brenda afatit të pranimi të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për

objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim: Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit, subjekti i shpronësuar Xhevahire Dibra (Radoveshi).

Afati i publikimit fillon më datë 16.9.2019 dhe mbaron më datë 16.10.2019.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019